REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSHTINA LIPLJAN
MUNICIPALITYOF LIPJAN

DATË/A	07.03.2018
REFERENC-Ë :	
PËR/ZA/TO:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunes se Lipjanit
CC:	Fauz Xheaili - Nënkryetar i Komunës Lipjan
	Lulzim Qerimi - Nënkryetar i Komunës Lipjan
NGA/OD/FROM:	Shkelzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim_____
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:	Raport Mujor 01.02.2018 - 28.02.2018

Më 09 Shkurt 2017 Komuna e Lipjanit ka aplikuar me projektin "Tregu u Gjelber" në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal në Programin për Zhvillim Rajonal 2018. Qëllimi i këtij programi ka qenë dhënja e kontributit në krijimin e kushteve për zhvillimin e ekonomik rajonal të qëndrueshëm në të gjitha rajonet ekonomike të Kosovës dhe për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik, mjedisor dhe kulturor të balancuar.

Në bashkëpunim me Agjencinë Zhvillimire Rajonale AZHR-Qendër, me 26.02.2018, kemi organizuar taikim inforumes me Sektorin Privat dhe qytatarët e intersuar lidhur me Skemën e Granteve nga Ministria e Zhvillimit Rajonal "Programi Zhvillimi Rajonal i Balansuar". Te pranishmit janë informuar në detale rreth kritereve dhe procedurave të aplikimit,

Në bashkëpunim me Organizatën Help, me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik përmes financimit të bizneseve të vogla dhe Start Up-ve, në Amfiteatrin e Shkollës Bujqësore Norges Vel kemi mbajtur dy sesione informuese me qytatarë dhe biznese më 06.02.2018 dhe 13.02.2018. Qellimi i këtyre sesioneve informuese ka qenë informimi rreth skemës së granteve nga Help e cila përfshinë dhënjen e 35 granteve për qytatarët dhe bizneset e vogla të Komunës së Lipjanit si dhe informimin rreth procesit të aplikimit dhe mbushjes së aplikacionit.

Në bashkëpunim me UNDP, Projektin ReLOaD kemi pëergatitur kriteret dhe dokumantacionin për shpallje të thirrjes për organizatat e shoqërisë civile. Thirrja është shpallur më 15 Shkurt 2018. Më tutje, projekti ReLOaD ka organizuar takimin informues mbi procedurat, kriteret dhe paketën e aplikimit me OSHC-të e Komunës së Lipjanit. Takimi Informues dhe Trajnimi është mbajtur më 26.02.2018, e Hënë dhe më 27.02.2018, e Martë, në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Lipjanit.

Në Sekorin Pronësoro-Juridik kemi dorëzuar raportin për pagesën e qerave, sipas kontratave të lidhura për lokalet dhe shfrytëzuesëve të tokave.

Jemi në proces të hartimit të Termave të Referencës për inicimin dhe shpalljen e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2018-2022.

Për shkak të riorganizimit të web-faqeve të Komunave, Zyra për marrëdhënie me Publikun dhe IT ende nuk kanë mundur ta vendosin Platformën Elektronike të Donatoreve në web-faqen e Komunës. Qellimi i kesaj Platforme Elektronike të Donatoreve eshte informimi me kohë i Sektorit Privat rreth burimeve të financimit përmës publikimt të thirrjeve nga donatorët në këtë platformë.

Më 08.02.2018 kemi marrë pjesë në takimin e Kolegjiumit të Drejtoreve Komunal për Zhvillim Ekonomik të organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosoves. Në këtë takim është zgjedhur kryesia e kolegjiumit dhe janë diskutuar ligjet dhe rregulluret të cilat rregullojne zhvillimin ekonomik lokal si dhe është diskutuar nevoja e rishiqimit të disa ligjeve. Në këtë takim, theks i veqantë i është dhënë Ligjit NR. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Rregullores Nr. 23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhenies në Shfrytezim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nevojës për ndryshimin e këtyre dy dokumenteve.

Më 28.02.2018, me kërkesën e Asablesë Komunale kemi raportuar rreth lokaleve afariste në pronësi të Komunës së Lipjanit dhe gjendjes së tyre.

Në muajin Shkurt janë regjistruar gjithsejt njëzet bizense të reja, dy biznese kanë ndërruar pronarin dhe gjashtë biznese kanë shtuar aktivitetet e tyre afariste.